



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 162, datë 21.12.2012

MBI

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
TË JO-JETËS “ANSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 55 të Ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 4, të statutit të shoqërisë së sigurimit të Jo-Jetës “Ansig” sh.a., si rezultat i zmadhimit të kapitalit, sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI